

KOMUNA - MITROVICË

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës

Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica



KONTRATË –FURNIZIM

TITULLI I KONTRATËS

Përshkrimi i Kontratës: **Furnizim me ushqim dhe material higjenik per Qerdhen e Femijeve ne arsimin parashkollor Q.F.”Gëzimi Ynë “-Komuna e Mitrovices**

NUMRI I PROKURIMIT: 642-19-8627-1-3-6

NUMRI I BRENDSHEM 642/19/052/136

AUTORITETI KONTRAKTUES: **KOMUNA E MITROVICËS**

OPERATORI EKONOMIK:

DPT,, Genc ”,

VËLLËZËRIT DRAGAJ,

40000, MITROVICË

DATA E NËSHKRIMIT: 06/12/2019

KONTRATË: Furnizim me ushqim dhe material higjenik per Qerdhen e Femijeve ne arsimin parashkollor Q.F.”Gëzimi Ynë “-Komuna e Mitrovices

Nr i prokur: 642-19-8627-1-3-6 dhe Nr i brend: 642/19/052/136

PJESA B: KONTRATA – FURNIZIM

KOMUNA- MITROVICË, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë;

dhe

DPT,, Genc ",

VËLLËZËRIT DRAGAJ,

, (në vazhdim "Kontraktori"), me nr Biznesi: 810458928 dhe nr i tel 049225020 ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike si vijon:

Furnizim me ushqim dhe material higjenik per Qerdhen e Femijeve ne arsimin parashkollor Q.F."Gëzimi Ynë "-Komuna e Mitrovices

- si në vijim:

Neni 1 Lënda: Furnizim me ushqim dhe material higjenik per Qerdhen e Femijeve ne arsimin parashkollor Q.F."Gëzimi Ynë "-Komuna e Mitrovices

me numër identifikues.

Nr i Prokurimit: 642-19-8627-1-3-6

Nr i brendshëm: 642/19/052/136

1.1 Lënda e kontratës do të jetë [FURNIZIMI], nga punëkryesi i punimeve si në vijim:

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: Largimi I kalldasë **Furnizim me ushqim dhe material higjenik per Qerdhen e Femijeve ne arsimin parashkollor Q.F."Gëzimi Ynë "-Komuna e Mitrovices**

Furnizim me ushqim dhe material higjenik per Qerdhen e Femijeve ne arsimin parashkollor Q.F."Gëzimi Ynë "-Komuna e Mitrovices		6'680.00€

1.2 Kontrata hynë në fuqi: me 06/12/2019 dhe sipas nevojës se IP "Gezimi Yne" do te porostë materialet e Kontratës ne afat deri më 06/03/2020.

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 2 ditë nga data e marrjes së urdhëreses.

KONTRATË: Furnizim me ushqim dhe material higjenik per Qerdhen e Femijeve ne arsimin parashkollor Q.F."Gëzimi Ynë "-Komuna e Mitrovices

Nr i prokur: 642-19-8627-1-3-6 dhe Nr i brend: 642/19/052/136

Furnizim me ushqim dhe material higjenik per Qerdhen e Femijeve ne arsimin parashkollor Q.F."Gëzimi Ynë "-Komuna e Mitrovices 1.4 Vendi i [kryerjes së FURNIZIMIT është sipas listës te cilën e përpilon IP GEZIMI YNE në Komunën e Mitrovicës.

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbuloohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Cmimi total i kontratës do të jetë: [6'680.00 €-(Gjashte mie e gjashtqind e tetedhjet euro)],

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj sipas furnizimeve të kryera të nënshkuara nga zyrtari pranues dhe Menaxheri i Kontratës ose shumën totale te pagesës ose sipas porosive te kryera nga O.E. për IP GEZIMI YNE.

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgesë]

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

KONTRATË: Furnizim me ushqim dhe material higjenik per Qerdhen e Femijeve ne arsimin parashkollor Q.F."Gëzimi Ynë "-Komuna e Mitrovices

Nr i prokur: 642-19-8627-1-3-6 dhe Nr i brend: 642/19/052/136

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i [furnizimeve] duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në DT dhe Përshkrimin e qmimeve..

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të jetë sipas specifikave të kërkuara me DT dhe Njoftimin për kontratë

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [te kryej ndonjë ose të gjitha punët] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së [punëve] të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik
12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së

KONTRATË: Furnizim me ushqim dhe material higjenik per Qerdhen e Femijeve ne arsimin parashkollor Q.F."Gëzimi Ynë "-Komuna e Mitrovices

Nr i prokur: 642-19-8627-1-3-6 dhe Nr i brend: 642/19/052/136

saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore 13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në [specifiko gjykatën kompetente] në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin ei identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën [Shqip] [Serbisht] [Anglisht] ² në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Autoritetin Kontraktues: Komuna-Mitrovicë	
Emri:	Haxhimet FERATI
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	06/12/2019
Vula:	

Për Kontraktorin: DPT,, Genc ", VËLLËZËRIT DRAGAJ, 40000, MITROVICË	
Emri:	BESIM SADIKU
Pozita:	MENAXHER
Nënshkrimi:	
Data:	06/12/2019
Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

KONTRATË: Furnizim me ushqim dhe material higjenik per Qerdhen e Femijeve ne arsimin parashkollor Q.F."Gëzimi Ynë "-Komuna e Mitrovices

Nr i prokur: 642-19-8627-1-3-6 dhe Nr i brend: 642/19/052/136